



Pranuar / Dostiguar Prijmljeno / Pristalo Received / Dostavio	17	01	2023	3	Viti God Year
Organ / Jedinica Org / Unit	Pr. Prof. Pr. Prof. Prot. No.	Shlopja Prilog Appendix		Sasia Kolicina Quantity	
SKMESHCK	450/2023		1/4		



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 624/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me nr.A.nr.613/2018, të datës 01.10.2018, së ankueses me adresë banimi rruga „ Selim Selimi, nga Komuna e Kaçanikut, kundër organit të punësimit Gjykata Themelore në Ferizaj në çështjen juridike “kontestim konkursi”, sipas Aktgjykimit A.nr. 691/2021 të datës 17.11.2022 të Gjykatës së Apelit -Departamentit për Çështje Administrative të pranuar në KPMSHCK me datë 15.12.2022, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.01.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr. 613/2018, e datës 01.10.2018, e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Njoftimi i datës 03.07.2018 i Gjykatës Themelore në Ferizaj.
- III. SHFUQIZOHET Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave nr. KA ne.04/2018 i datës 22.08.2018 të Gjykatës Themelore në Ferizaj

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.11.2018, me numër protokolli 6689/2018, ka nxjerr vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses Gjylsha Shurdhani, duke e shfuqizuar Vendimin KA Nr. 04/2018, të datës 22.08.2018, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore Ferizaj.

Ankuesja Gjylsha Shurdhani, e pakënaqur me vendimin e datë 08.11.2018, me numër protokolli 6689/2018, të KPMSHCK, ka hapur konflikt administrative, në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 09.06.2021 A. Nr. 2925/2021, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses duke anuluar vendimin A. Nr. 613/2018, të datës 06.11.2018, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e kthyer çështjen në rivendosje dhe rishqyrtim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.07.2021, me numër protokolli 3739/2021 ka parashtruar ankesë në Gjykata e Apelit, për mes Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kundër Aktgjykimit A. Nr. 2925/2021, të datës 09.06.2021.

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative, ka nxjerr aktgjykim me nr. A.A.Nr. 691/2021, të datës 17.11.2022, me të cilin Aktgjykim ka refuzuar ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vërtetuar Aktgjykim A. Nr. 2925/2021, të datës 09.06.2021, të Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 5623/2018, e datës 01.10.2018, me numër protokolli 5623/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A. a. Nr. 691/2021, i Gjykatës së Apelit; Ankesë e datës 15.07.2021, drejtuar Gjykatës së Apelit; Aktgjykimi A. Nr. 2925/2028, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; përgjigje në padi e datës 03.02.2021; Vendimi i datës 22.08.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Certifikatë e datës 30.05.2016; dëshmi nga trusti; Njoftimi i datës 03.07.2018; Renditja përfundimtare e Kandidateve; Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale; Testi me shkrim për kandidatin Kërkesa për punësim e ne shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 20.09.2007; certifikatë e datës 29.12.2017, për dhënien e provimit të jurisprudencës; Vërtetim i datës 01.02.2013; Vërtetim i datës 02.06.2011; Vërtetim i datës 31.12.2013; vendim i datës 31.01.2018; Vlerësimi Individual i candidateve për vendin e punës për të cilët nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testi me shkrim i kandidatës Kërkesa për punësim e znj, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 11.03.2011; Certifikatë e datës 25.09.2016 për dhënien e provimit të jurisprudencës; Certifikatë e datës 25.07.2014; Vërtetim i datës 24.11.2015; Testi me shkrimi i kandidatit; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 20.09.2003; Certifikatë e datës 31.01.2017, për dhënien e provimit të jurisprudencës; Vërtetim i datës 13.02.2018; Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë; Certifikatë e datës 03.10.2003; Testi me shkrim i kandidatit Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 03.01.2013; Vërtetim punësim i datës 22.03.2018; certifikate e datës 18.09.2014; certifikatë e datës 10.1.2014, për dhënien e provimit të jurisprudencës; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 28.09.2010; Certifikatë e datës 02.06.2017; Vërtetim i datës 26.05.2014; Vërtetim i datës 30.06.2011; Certifikatë e datës 25.05.2016; dëshmi nga trusti; Certifikatë e datës 29.07.2016; Lista e ngushtë; Përcaktimi i



Kritereve për përfshirje në Listën e Ngushtë; Regjistrimi i Aplikacioneve të Pranuar; Vendim i datës 14.06.2018; Konkursi i datës 28.05.2018; Autorizimi i datës 24.05.2018, i Ministrisë së Administratës Publike; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Akt Emërimi i datës 24.11.2014; Certifikatë e datës 25.06.2014; Diplomë e datës 03.02.2010; Certifikatë e datës 16.08.2017, për dhënien e provimit të jurisprudencës; Certifikatë e datës 30.05.2016; Dëshmi nga Trusti; Përgjigje në ankesë e datës 12.10.2018, me numër protokolli 5936/2018;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar Aktgjykimin e datës A.A.Nr. 691/2022, A.Nr. 2660/2021, të Gjykatës së Apelit/Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim ka refuzuar ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vërtetuar Aktgjykim A. Nr. 2925/2021, të datës 09.06.2021, të Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, sipas këtyre aktgjykimeve KPMSHCK në vendimin me nr. Anr.613/2018 ka shfuqizuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave KA.Nr.04/2018 i datës 22.08.2018 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, duke mos udhëzuar se si të veprojnë më tutje në këtë çështje juridike.

Ndërlidhur me sugjerimet e Aktgjykimit të datës A.A.Nr.691/2022, të Gjykatës së Apelit/Departamentit për Çështje Administrative, me të cilin aktgjykim është konstatuar se vendimin i Këshilli, diapozitivi ka qenë në kundërshtim me arsyetim, Kolegji konstaton se vendim të datës 08.11.2018, me numër protokolli 6689/2018, Këshilli, ka refuzuar ankesën e ankueses Gjylsha Shurdhani, duke e shfuqizuar Vendimi KA.Nr.04/2018, të datës 22.08.2018, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Gjykatës Themelore Ferizaj dhe si rrjedhojë e kësaj ka mbetë në fuqi njoftimi i datës 03.07.2018 i Gjykatës Themelore në Ferizaj, lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve. Kolegji i Këshillit ka refuzuar ankesën e ankueses sepse ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, sepse njoftimi për mos përfshirjen në listën e ngushtë të ankueses është bërë me datë 20.06.2018 nga ana e Gjykatës Themelore në Ferizaj, ndërsa ankuesja ankesën e ka bërë në Komision me datë: 04.08.2018 përmes postës, andaj ankesa është parashtruar në Komision në kundërshtim me dispozitat e nenit 42 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku paragrafi 1 i nenit 43 përcakton se: "Kur një nëpunës civil i cili asht kandidat në një procedurë të brendshme të rekrutimit ose një të jashtëm janë refuzuar të marrin pjesë në procedurën e rekrutimit dhe kandidati mendon se refuzimi është i paarsyeshëm ose në Kundërshtim me rregullat dhe procedurat ekzistuese, ai/ ajo mund të ankohet me shkrim në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i cili e shqyrton dhe Vendos. 2 Ankesa duhet të dorëzohet brenda 30 ditëve nga data e pranimit të njoftimit të refuzimit nga KPSHC, përkatëse.

Sa i përket vendimmarrjes nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore në Ferizaj, me të cilin vendim ka refuzuar ankesën e ankueses

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore në Ferizaj, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr.04/2018, të datës 22.08.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e të



Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankueses për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar i lartë për bashkëpunim Profesional pese (5) pozita në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe një (1), pozitë dega Kaçanik", të zhvilluara nga Gjykata Themelore në Ferizaj, sepse ankuesja ankesën tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Themelore në Ferizaj, e ka parashtruar jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesave, në rastin e procedurave të rekrutimit, dhe një vendim i tillë nuk prodhon efekt juridik, për arsye së ankesa tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, nga ankuesja është parashtruar jashtë afatit ligjor. Prandaj nisur nga konstatimi i gjendjes faktike dhe ligjore Kolegji ka shfuqizuar Vendimin KA nr.04/2018 i datës 22.08.2018 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, sepse një vendim i marrur në shkelje të ligjit material dhe procedural nuk mundet të mbetet në fuqi, si rrjedhojë e kësaj Kolegji ka lënë në fuqi përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve sipas konkursit të datë 20.05.2018.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA NR. A. NR. 624/2021

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj;
- Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën Themelore në Ferizaj;
- Arkivit të KPMSHCK-së

